Pml.nr.34/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar, Nesrin Lushta e Mejreme Memaj, anëtare, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurit M.Z., nga K., për shkak të veprës penale organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës nga neni 160 par.2 lidhur me par.1 të KPK, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë PKR.nr.64/2018 të datës 08.03.2019 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.244/2019 të datës 01.10.2019, në seancën e mbajtur me datën 18.02.2020, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të Prokurorit të Shtetit të Kosovës konstatohet se aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë PKR.nr.64/2018 i datës 08.03.2019 dhe aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.244/2019 i datës 01.10.2019 janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 12 të KPPK.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë PKR.nr.64/2018 të datës 08.03.2019. i pandehuri M.Z. është liruar nga akuza për veprën penale organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës nga neni 160.par.2.lidhur me par.1.të KPK. Është vendosur që shpenzimet e procedurës penale bijën në barë të mjeteve buxhetore të gjykatës ndërsa për realizimin e kërkesës pronësoro juridike të dëmtuarit janë udhëzuar në kontestin civil.

Në procedurën ankimore, me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.244/2019 të datës 01.10.2019 është refuzuar si e pabazuar

ankesa e Prokurorit Special të Republikës së Kosovës dhe aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtën e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit të Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që shkeljet të konstatohen.

Mbrojtësi i të pandehurit, avokati D.V. nga M., ka paraqitur përgjigje në kërkesë në të cilën ka theksuar se ricilësimi i veprës penale nga vepra penale krime të luftës në kundërshtim të rëndë me nenin 3 të përbashkët me Konventat e Gjenevës (krime kundër popullsisë civile) nga neni 31.dhe 152. me shkelje të nenit 22 dhe 142 të KPK në veprën penale organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës nga neni 160 par.2 lidhur me par.1 të KPK, siç ka vepruar prokurori por edhe gjykata, nuk është i mundur sepse kjo vepër nuk ka qenë e paraparë me Ligjin Penal të RSFJ i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale. Ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë si dhe ato në përgjigjen e dhënë dhe konstatojë se:

- kërkesa është e bazuar.

Gjykata Supreme së pari konstatoj se nuk është i bazuar pretendimi në përgjigje në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë sepse në Ligjin Penal të RSFJ i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, ka ekzistuar vepra penale organizimi i grupit dhe shtytja në kryerjen e gjenocidit dhe të krimit të luftës, e paraparë me nenin 145 të tij, me përmbajtje të njëjtë sikurse vepra aktuale penale (me dallim vetëm në dënimin e paraparë).

Nga aktgjykimi i shkallës së parë rezulton se përshkrimi i veprimeve të cilat të pandehurit i vihen në barë është se:

- në periudhën kohore qershor-korrik 1998 në fshatin D., komuna e K., aktivisht ka marrë pjesë në grupin që ishte organizuar për kryerjen e veprave penale, në atë mënyrë që si anëtar i grupit që ishte organizuar në mënyrë që të marrin pjesë aktive në ofensivat kundër popullsisë shqiptare, grup i përbërë dhe i organizuar nga pjesëtarët të forcave serbe, si polic, ushtar dhe paramilitar serb, së bashku me serbët të fshatit D., i pandehuri dhe NN personat, murrën pjesë në organizimin e përgatitjen për sulm, u përgatit shtëpia e të pandehurit për sulme që do të ndërmerreshin ndaj popullatës së pa mbrojtur shqiptare, shtëpia e tij shërbeu si bazë e forcave serbe, ashtu që

rreth pronës së tij, tek çatia dhe ballkoni fortifikuan vendin me thasë të mbushur me rërë dhe më 19 qershor 1998 rreth orës 12:00 në fshatin D., i pandehuri i veshur në pjesën e epërme me uniformë ushtarake dhe në pjesën e poshtme me pantolla civile, nga vetura e tij "Z.1.." ngjyrë të verdhë shkarkoi të shtëpia e tij armë të kalibrit të ndryshëm, në mbrëmje nga ballkoni i shtëpisë së tij, është shtënë me automatik në drejtim të shtëpive të shqiptarëve - popullatës civile të pambrojtur, të cilët nga frika, kërcënimet dhe sulmet e armatosura që u nisën në drejtim të fshatit D., fillojnë të largohen nga fshati të gjithë personat që patën mundësi fizike, ndërsa personat që nuk patën mundësi, si Z., O. dhe H.M. (i cili ishte i paralizuar) qëndruan në shtëpinë e tyre, ndërsa pasditen e të njëjtës ditë filluan sulmet e serbëve në drejtim të fshatit, nga shtëpia e të pandehurit u dhanë urdhra, u mbajtën pikat e forcave serbe, veçanërisht pikat e topave të cilat ishin më të rëndësishme për ushtrinë serbe, nga sulmet që u ndërmarrën në ofensivën që fillojë më datën 28.07.1998, u dogjën në tërësi shtëpitë e shqiptarëve në fshatin Dush, u dogjën Z., O. dhe H.M., të cilët qëndruan në shtëpinë e tyre, pasi që nuk patën mundësi të largohen, gjatë sulmeve që u bënë nga M.Z. dhe NN personat e të cilat sulme u bënë edhe nga shtëpia e të pandehurit M.Z., pjesë e të cilave sulme ishte edhe vet i pandehuri, u plagosën E.M. dhe R.M., këto sulme zgjatën gjatë muajit qershor-korrik të vitit 1998. ndërsa si pasojë e depërtimeve nga shtëpitë e tyre janë vrarë dhe djegur gruaja dhe vajzat e të dëmtuarit Xh.M. në fshatin R. të P.

Andaj, veprimet që i vihen në barë të pandehurit kanë qenë qenia anëtarë i grupit i cili ka qenë i organizuar për kryerjen e veprave penale (nga përmbajtja e mëtutjeshme del se është fjalë për veprat penale kundër jetës së popullsisë civile) e pastaj veprimet konkrete të cilat i ka ndërmarrë në këtë cilësi, siç janë përgatitjet për sulm (vendosja e thasëve me rërë në çatinë dhe ballkonin e shtëpisë së tij), shkarkimi i armëve në po atë shtëpi dhe sulmet-shtënjet me armë në drejtim të popullatës së pambrojtur civile, me pasojat e përshkruara.

Në aktgjykimin e shkallës së parë përshkruhet përmbajtja e deklaratave të dëshmitarëve I., Xh., G., A., V., B., M., E., H., R., A. dhe A.M., por nga arsyetimi rezulton se gjykata nuk iu ka kushtuar besim sepse ka pas shumë ndryshime në deklaratat e tyre të dhëna në procedurën paraprake dhe te prokurori i shtetit si dhe disa prej tyre nuk kanë dëshmuar për ngjarjet të cilat personalisht i kanë pa, por për atë se çka i kanë treguar të tjerët.

Në tërë arsyetimin e aktgjykimit bëhet fjalë për veprimet konkrete e të pandehurit, siç janë prania e tij në vendin e ngjarjes në kohën kritike, përgatitjet për ofensivën siç janë sjellja e thasëve me rërë dhe vendosja në ballkonin dhe çatinë e shtëpisë së të pandehurit, sjellja e armatimit dhe veprimet tjera siç janë sulmet e tij nga arma ndaj popullatës civile, e të cilat veprime, sipas aktgjykimeve të kundërshtuara, nuk janë vërtetuar.

Mirëpo, sipas nenit 160 par.1 të KPK veprën penale organizimi i grupeve për kryerjen e gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës e kryen kushdo që organizon një grup me qëllim të kryerjes së ndonjë prej veprave penale nga nenet 148 -156 të këtij Kodi ndërsa veprën penale nga par.2. i këtij neni, kushdo që bëhet anëtarë i grupit nga par.1 të këtij neni.

Në rastin konkret, në aktgjykimet e kundërshtuara nuk bëhet fjalë për organizimin e grupit nga neni 160 të KPK e as për bërjen anëtar i tij, edhe pse fjala është për elementin qenësore të veprës penale nga aktakuza. Në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë pretendohet se disa rrethana, e posaçërisht fakti se vet i pandehuri ka deklaruar se natën kritike ka qenë duke kujdestaruar, tregon se ka qenë anëtar i grupit që mori pjesë në kryerjen e krimeve të luftës në atë kohë. Megjithatë, këtij fakti nuk iu është dhënë rëndësi, që paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika12 të KPPK.

Në aktgjykimet e veta, gjykatat nuk kanë bërë dallim në mes anëtarësimit në grup i cili definohet në nenin 160 par.2 të KPK dhe kryerjes së veprimeve për të cilin grupi është themeluar edhe pse fjala është për dy veprime të cilat ligji qartazi i dallon. Kështu, organizimi i grupit dhe anëtarësimi në grup, paraqet veprim i cili inkriminohet si vepër individuale penale. Ai paraqet një stad paraprak dhe për të ekzistuar kjo vepër penale, nuk kërkohet që anëtari i grupit edhe të kryej veprën penale për të cilin grupi është themeluar. Përkundrazi, mjafton vetëm organizimi i grupit gjegjësisht anëtarësimi në grup. Në rast se ekzekutori e kryen veprën penale për të cilin grupi është themeluar (gjenocidi etj.) atëherë fare nuk ekziston vepra penale nga neni 160 të KPK por vepra penale për kryerjen e së cilës grupi është organizuar (gjenocid etj.).

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, mungesa e plotë e arsyeve për këtë element qenësore të veprës penale për të cilën i pandehuri është akuzuar paraqet shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni i cekur më lartë, për çka kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e bazuar dhe si e tillë u aprovua.

Gjykata Supreme vërejti se në përshkrimin e veprimeve inkriminuese në aktakuzë por edhe në aktgjykimin e shkallës së parë, mungon precizimi se për kryerjen e cilës vepër penale grupi është organizuar edhe pse sipas nenit 160 par.1 të KPK kjo vepër penale ekziston nëse grupi organizohet për kryerjen e ndonjërës prej veprave penale nga neni 148 -156 të KPK. Megjithatë, gjykatat në aktgjykimet e kundërshtuara nuk e kanë liruar të pandehurin duke u ndërlidhur me këtë fakt, por për mos vërtetimin e kryerjes së veprimeve kundër popullsisë civile dhe për këtë shkelje eventuale, nuk ishte paraqitur kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë.

Andaj, aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 12 të KPPK e cila shkelje, konform dispozitës së nenit 438 par.2 të KPPK u konstatua, pa ndikuar në vendimin e formës së prerë, sepse kërkesa ishte paraqitur në dëm të pandehurit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
Pml.nr.34/2019, më datë 18.02.2020

Procesmbajtësi,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi